

Përkrahje për kandidatët

14 hapa për të realizuar një prezentim dhe performancë të shkëlqyeshme në intervistë

KOSOVË: Fuqizimi i qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare - FCO CSSF

Versioni 1.0

14 hapa për të realizuar një prezentim dhe performancë të shkëlqyeshme në intervistë

Urime, aplikimi juaj ka qenë i suksesshëm dhe tani e keni pranuar ftesën për një Prezentim dhe Intervistë.

Qëllimi juaj është që të bëni një prezentim interesant dhe sqarues i cili tregon se si përvoja juaj është ajo që përshtatet shumë me këtë pozitë. Ju nuk e dini se sa të mirë janë kandidatët tjerë - por duke u përgatitur mirë do të maksimizoni gjasat tuaja për sukses.

Hapi	Veprimi	✓
1	Udhëzuesi për kandidatë Juve duhet të ju dërgohen disa materiale për Udhëzim të Kandidatëve. Këto sqarojnë procesin. Lexoni këtë me kujdes dhe shënoni kohët e parapara dhe kompetencat.	
2	Tema e prezentimit Lexojeni këtë temë. Shikoni çdo gjë që kërkohet ta përfshini në prezentim. Mund të jenë dy ose tri elemente. Shikojeni secilën ndarazi. Kjo do të ju ndihmojë ta strukturoni prezentimin tuaj sipas asaj që ju kërkohet ta bëni. Kjo gjithashtu do të ju tregojë se si ta shfrytëzoni kohën që e keni për prezentim.	
3	Hulumtoni për temën e prezentimit Ju mund të jeni ekspert në atë fushë, megjithatë, prapë do të keni nevojë të bëni hulumtim për ta shmangur mbështetjen në atë që e aktualisht dini dhe mendoni. Gjeni publikimet relevante nga ai organ publik, shqyrtoni ngjarjet e fundit që mund të kenë ndikuar në atë institucion dhe shikoni se çka është thënë për atë institucion politikisht, ndërkombëtarisht dhe në medie.	
4	Shtoni mendimet tuaja Pasi ta keni bërë hulumtimin - shtoni mendimin tuaj. Varësisht nga tema e prezentimit, kjo mund të lidhet me drejtimin strategjik që institucioni duhet ta ketë, dhe çka duhet bërë për ta mundësuar realizimin e tij. Fushat tjera që ndoshta do të dëshironi t'i shqyrtonit janë strategjia sjuaj për institucionin dhe se si do të ndikonit në strategjinë e tij nëse kjo nuk është detyra e drejtpërdrejt për të cilën po aplikoni. Gjithashtu - çka do të bëni personalisht, cili është plani juaj për ta realizuar përgjegjësinë organizative? Cilat do të jenë prioritetet tuaja dhe me të cilat institucione dhe akterë do të punoni për të realizuar planin tuaj dhe strategjinë? Si do ta bëni këtë? Nëse keni një plan të qartë do të jetë më bindës sesa një listë me ide të përgjithshme, të shpërndara dhe të paplanifikuara.	
5	Planifikimi i prezentimit tuaj Tani keni menduar hollësisht për këtë pozitë dhe për organizatën, tani është koha ta përgatitni prezentimin. Pjesa më e rëndësishme e një prezentimi është planifikimi dhe përgatitja. Nëse prezentimi juaj nuk është strukturuar - me informata bazike dhe përmbajtje relevante për	

	<p>pozitën dhe organizatën ose agjencinë - nuk do të duket si prezentim i besueshëm për dëgjuesin.</p> <p>Kthehuni te tema e prezentimit dhe elementet individuale që i keni radhitur në hapin e mëhershëm.</p> <p>Mendoni se sa kohë do t'i kushtoni secilit element të prezentimit. Do të duhej të përkujdeseshit që mund të mbuloni të gjitha aspektet e pyetjeve të prezentimit brenda kohës së lejuar. Shfrytëzoni kohën e plotë që është caktuar; mosshfrytëzimi i mjaftueshëm i kohës dmth që ju jepni më pak dëshmi për poentim, dhe në anën tjetër, tejkalimi i kohës nënkupton që mund të ju shmangen disa pika dhe tregon menaxhim të dobët të kohës. Nëse e arrini fundin e kohës së caktuar do të ndërpriteni - kjo mund të nënkuptojë që do ta humbni mundësinë për të përfshirë disa pika të rëndësishme.</p> <p>Duke e pasur parasysh që koha ka rëndësi kritike, ushtrojeni prezentimin për të parë se a mund ta realizoni brenda kohës së caktuar.</p> <p>Puna juaj është që edhe të ja komunikoni këtë komisionit në mënyrë bindëse dhe të besueshme. Kështu që, përdorni shënime nëse keni nevojë - por mundohuni t'i shmangeni leximit të thjeshtë të prezentimit pasi që kjo do të dëmtojë efektin që e keni në komunikimin tuaj.</p> <p>Mendoni për temën për të cilën ju është kërkuar të prezentoni. Nëse ju do të ishit komisioni - çfarë kompetencash mund të kërkojnë ata për të grumbulluar dëshmi: rishikoni prezentimin tuaj dhe shikoni se a keni gjasa t'i trajtoni këto fusha.</p> <p>Gjatë prezentimit mund të përdorni shënime por me të përfunduar do të kërkohet nga ju që t'i largoni anash ato shënime gjatë pjesës tjetër të intervistës dhe të mos i referoheni. Juve do t'u jepet një laps dhe letër për të marrë shënime tjera që ju duhen gjatë intervistës por në fund të intervistës do t'i lini këto.</p>	
6	<p>Pyetjet teknike</p> <p>Pyetjet teknike përdoren nga Komisioni për të hulumtuar të menduarit tuaj për institucionin dhe pozitën për të cilën aplikoni.</p> <p>Këto përqendrohen në disa prej sfidave kritike të cilat bartësi i pozitës duhet t'i trajtojë. Këto mund të jenë strategjike, operative, financiare, teknike, që kërkojnë inovacione, dhe/ose ndërlidhen me atë se si punoni me institucionet dhe akterët tjerë. Nga ju pritët që të keni ide të qarta dhe të propozoni qasje. Duhet të jeni të vetëdijshëm për fushat e mundshme nga hulumtimi juaj dhe t'i keni përgatitur mendimet tuaja për të gjitha çështjet si pjesë e përgatitjes suaj për prezentim. Përgjithësisht, këto pyetje, bashkë me prezentimin, janë mundësia juaj më e mirë për të treguar përvojën tuaj relevante teknike për pozitën.</p>	
7	<p>Intervista - Kompetencat</p> <p>Intervista bazuar në kompetencë matet në kohë, është e strukturuar dhe përbëhet nga pyetje specifike që lidhen me secilën fushë të kompetencës që vlerësohet. Intervistuesi do të zgjedhë kompetencat më të rëndësishme për atë vend pune dhe do të marrin nga ju shembuj specifik</p>	

	<p>nga e sjelljet tuaja në të kaluarën lidhur me secilën kompetencë. Intervistat e bazuara në kompetencë kërkojnë dëshmi për përshatshmërinë tuaj për një pozitë përmes shembujve specifik se si e keni demonstruar përvojën tuaj më herët lidhur me sjelljet që janë thelbësore për atë pozitë.</p> <p>Hapi i parë është radhitja e të gjitha kompetencave - janë 11 dhe këto ofrohen në kuadër të Udhëzuesit për Kandidatët. Prezentimi do të lidhet me disa prej tyre ndërsa Intervista do t'i hulumtojë të tjerat. Ju lutem vëreni, është normale që të mos mbulojnë të gjitha kompetencat. Komisioni i zgjedhë ato që i sheh si më të rëndësishme për suksesin e asaj pozite dhe institucioni. Kështu që, puna juaj e ardhshme është që të shikoni se cilat kompetenca ka më shumë gjasa që t'i interesojnë Komisionit për këtë pozitë dhe institucion. Mos i lini anash edhe kompetencat tjera, por kjo ju jep një ide se çfarë pyetjesh mund të ju bëhen gjatë intervistës.</p>	
8	<p>Intervista - Shembuj nga përvojat e kaluara</p> <p>Intervistat e bazuara në kompetencë përbëhen nga pyetje që kërkojnë të përshkruani situata specifike nga e kaluara juaj dhe të shpjegoni se si i keni menaxhuar ato situata. Intervistat e bazuara në kompetencë bazohen mbi parimin që sjellja në të kaluarën është parashikues i mirë për sjelljen e ardhshme - një shembull i pyetjes nga intervista mund të jetë: “Më tregoni një rast kur keni vazhduar të arrini rezultate pavarësisht zvogëlimit të financimit?”</p> <p>Gjatë përgatitjes për këto pyetje - radhitni të gjitha kompetencat. Bëni një listë të shembujve që ju ndihmojnë të tregoni realizimet në secilën nga këto fusha të kompetencës. Disa shembujt tuaj do të jenë demonstrim më i mirë i kompetencave specifike. Është mirë të keni disa shembuj pasi që nuk do ta dini theksin e saktë të pyetjes që ju bëhet juve. Mos supozoni që ajo që ju e konsideroni si shembullin më të mirë gjithsesi do t'i përgjigjet pyetjes që ju bëhet - mund të jepni shembull të mirë por nuk i përgjigjeni pyetjes dhe kjo pastaj rezulton me poentim të ulët. Përgatituni të jeni fleksibil - përdorni dëshminë e duhur për pyetjen që ju parashtrohet.</p>	
9	<p>Intervista - Relevanca</p> <p>Vlerësoni shembujt tuaj të përgatitur për relevancën e pozitës dhe institucionit ku po i aplikoni. Mbani mend, po mundoheni të tregoni se si do të shtoni vlerë dhe realizoni rolin për të cilin keni aplikuar. Komisioni po shikon se sa relevant janë shembujt që i paraqitni. Sa më relevant të jenë ata për sfidat me të cilat ballafaqohet institucioni aq më mirë do të vlerësohen. P.sh. a janë ata shembuj nga e njëjta industri apo sektor? A janë për llojin e njëjtë të pozitës dhe madhësinë e organizatës?”.</p>	
10	<p>Intervista - Niveli për pozitën</p> <p>Përveç që duhet të jenë relevant shembuj tuaj, Komisionit gjithashtu do t'i interesojë edhe niveli i pozitës që keni pasur në shembujt që i përdorni. Ndoshta ju tashmë i keni përmbushur kriteret themelore minimale për përvojë menaxheriale në fazën e listë së ngushtë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që përvoja juaj menaxheriale është në nivelin e mjaftueshëm për të demonstruar qartë që ju jeni i gatshëm ta merrni detyrën në fjalë, sidomos nëse është pozitë</p>	

	<p>e lartë e nivelit strategjik. Duhet të përkujdeseni që shembujt që i përdorni vërtetë demonstrojnë gatishmërinë tuaj për t'u ballafaquar me këto sfida sa i përket kompleksitetit dhe kërkesave të situatave të kaluara që i përshkruani. Ka më pak gjasa të vlerësoheni për shembujt që demonstrojnë menaxhim relativisht të ulët apo përgjegjësi mbikëqyrëse p.sh. situatat ku keni trajtuar çështje relativisht direkte me një person. Nëse aplikoni për një pozitë ku do të jeni përgjegjës për të menaxhuar një institucion me qindra njerëz, duhet të siguroheni që shembujt tuaj të demonstrojnë që jeni të gatshëm për përgjegjësitë dhe sfidat që do të sjellë kjo.</p>	
11	<p>Intervista - Roli juaj</p> <p>Gjatë përgatitjes dhe dhënies së përgjigjeve tuaja, jini të qartë për rolin tuaj personal. Të flitet për sukseset personale mund të jetë jo e lehtë për shumë njerëz. Megjithatë, Komisionit i duhet të dijë se çfarë veprimesh keni ndërmarrë dhe çfarë vendimesh keni bërë. Atyre gjithashtu ju intereson të dijë se kush tjetër ishte i përfshirë dhe çka kanë bërë ata lidhur veprimet dhe vendimet tuaja - ata nuk do të presin që ju të keni bërë gjithçka vetëm - megjithatë, nëse është pozitë e lartë ata do të presin që ju të keni pasur përgjegjësinë dhe llogaridhënien e përgjithshme.</p> <p>Derisa në njërin anë është e zakonshme të bëhet punë si pjesë e ekipit - kur flitet për 'Ne' në vend të 'Unë' është e padobishme dhe mund të rezultojë me vlerësime më të ulëta, thjeshtë sepse është e pamundur për komisionin të shoh se cili ka qenë kontributi juaj personal në atë situatë. Ju mund flisni për punën e realizuar në ekip - por jini të qartë për kontributin tuaj personal dhe unik për këtë p.sh. cilat ide ishin tuajat? Çfarë vendimesh keni marrë ju? Çfarë veprimesh keni udhëhequr ju?</p>	
12	<p>Intervista - Pyetjet e drejtuara kah e ardhmja</p> <p>Derisa shumica e pyetjeve do të drejtohen kah përvoja juaj e kaluar, ata mund të ju bëjnë edhe pyetje të drejtuara kah e ardhmja. Nganjëherë këto quhen pyetje hipotetike. Ato me gjasë përqendrohen në sfidat dhe çështjet kryesore për pozitën dhe organizatën. Për shembull: "Nëse financimi zvogëlohet çka do të bënit për ta vazhduar punën". Këto janë të ngjashme me Pyetjet Teknike dhe pasi që ju tani jeni përgatitur plotësisht për këto si pjesë e Prezentimit, duhet të kenë vetëbesim që mund të përgjigjeni në çdo pyetje të Komisionit.</p>	
13	<p>Intervista - Strukturimi i përgjigjeve tuaja</p> <p>Përgjigjet tuaja duhet të ja komunikoni Komisionit. Kjo nënkupton më tepër sesa përgjigje në pyetje. Si ndihmë, është e dobishme të përdoret struktura e mëposhtme për të paraqitur atë që e kërkon Komisioni:</p> <p>STAR</p> <p>(S) Situata - përshkruani situatën dhe ngjarjet relevante që kanë sjellë deri te ajo. Ju e vendosni kontekstin. Në kuadër të kësaj duhet të jeni të qartë për pozitën tuaj që e keni pasur në atë kohë, niveli e saj dhe relevancën e situatës për kontekstin e pozitës/institucionit ku keni aplikuar. Jini konciz në përshkrimin e situatës, mbani mend që komisionit do t'i interesojnë më shumë fazat në vijim - dmth çka keni bërë ju në të vërtetë.</p>	

	<p>(T) Detyra - ajo që është kërkuar të arrini si rezultat; çka jeni munduar të arrini apo strategjinë/detyrën që jeni munduar ta përmbushni në këtë rast.</p> <p>(A) Veprimi - ajo çka keni bërë; veprimet që i keni ndërmarrë; ndërhyrjet që i keni bërë; bisedat me akterët kryesorë që i keni pasur etj. 70% e kohës së përgjigjes tuaj duhet të përdoret për të dhënë informata për veprimet që i keni marrë personalisht.</p> <p>(R) Rezultati - në fund, Komisionit do t'i interesojë ndikimi. Çka keni arritur si rrjedhojë e drejtpërdrejt e veprimeve që ju i keni ndërmarrë? Pse nuk do të ishte arritur kjo pa inputin/veprimet tuaja? Mund edhe të përfshijë atë që ka ndodhur prej atëherë dhe cila është gjendja e kësaj çështjeje tani?</p> <p>Shembull: Kompetenca e komunikimit</p> <p>Aftësia juaj për të komunikuar në mënyrë efektive dhe ndikuar te të tjerët për të vepruar për të përkrahur synimet tuaja dhe të ekipit, mund të ekzaminohet. Këtu është me rëndësi aftësia për të përshtatur metodat tuaja të komunikimit varësisht nga situatat dhe individët.</p> <p>Një shembull i pyetjes së intervistës për këtë kompetencë: Vëreni që kjo pyetje bëhet për të ilustruar strukturën e një pyetjeje të kompetencës dhe nuk është pyetje që vërtetë do t'u parashtrohet:</p> <p>P: Na tregoni një rast kur keni ndikuar te një koleg që të përvetësojë mënyrën tuaj të menduarit?</p> <p><i>Përdoreni modelin STAR për t'u përgjigjur: çfarë ka qenë situata, çka keni bërë dhe çka keni dashur të arrini, ose cilat ishin synimet tuaja, cilat ishin veprimet specifike që i keni ndërmarrë dhe cili ishte rezultati?</i></p> <p>Shembuj të nënpyetjeve - Çfarë vështirësish keni hasur? Si i jeni qasur këtyre?</p>	
14	<p>Intervista - Një diskutim me qëllim</p> <p>Jini të vetëdijshëm që intervista është një diskutim me qëllim të mbledhjes së dëshmive së përshtatshmërisë për të vlerësuar secilin kandidat. Përveç pyetjes së kompetencës, Komisioni do të trajtojë përgjigjet tuaja më tutje me pyetje shtesë dhe plotësuese. Dëgjoni përgjigjet me kujdes - sigurohuni që i keni kuptuar pyetjet e tyre. Pyetjet shtesë quhen pyetje kontrolluese (nënpyetje) dhe përmes tyre kërkohen më shumë dëshmi nga kandidatët për fushat specifike që i interesojnë Komisionit - në efekt, ato u ndihmojnë kandidatëve të performojnë më mirë. Pasi që është një mundësi për të paraqitur më shumë hollësi dhe dëshmi për përvojën tuaj.</p> <p>Komisionet gjithashtu do të ndërpresin kandidatët, sidomos nëse dilni jashtë temës apo nuk i përgjigjen pyetjes drejtpërdrejt - ta keni parasysh që Komisioni nuk është i pasjellshëm por mundohet që të përkujdeset që ta shfrytëzoni kohën në mënyrën më efektive për të paraqitur atë që mund ta ofroni dhe ata mundohen të sigurojnë drejtësi duke i dhënë kohën e njëjtë për intervistë secilit kandidat.</p>	

	<p>Gjatë hyrjes, juve do të ju njoftojnë se sa fusha të kompetencës do të mbulohen gjatë intervistës dhe për sa kohë. Një matematikë e thjeshtë se sa zgjatë afërsisht secila pjesë për të ju ndihmuar që ta menaxhoni kohën tuaj në mënyrë efektive p.sh. nëse intervista zgjatë 35 minuta dhe janë pesë kompetenca do ta dini se i keni rreth 7 minuta për secilën pyetje. Mundohuni të flisni qartë dhe me përmbledhje gjatë tërë kohës.</p>	
--	---	--